

FOL

**(Mos) zbatimi i Ligjit për Deklarim të
Pasurisë nga Qeveria Haradinaj,
Kurti 1 dhe Hoti**



Titulli: (Mos) zbatimi i Ligjit për Deklarim të Pasurisë nga Qeveria

Haradinaj, Kurti 1 dhe Hoti **Autor:** Albana Hasani & Flkrije Sinani

Viti i botimit: Gusht 2021

Publikuar nga: Lëvizja FOL

Andrea Gropa nr.35

Prishtinë 10000, Republika e Kosovës

info@levizjafol.org

+386 (0)49 131 542



Të drejtat e autorit © 2021. Lëvizja FOL. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të ruajtjes së të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë elektronike, mekanike, fotokopjuese, incizuese apo tjetër, pa pëlqimin paraprak me shkrim nga ana e botuesit.

Ky projekt u financua nga granti i Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur. Opinionet, gjetjet dhe përfundimet e shprehura në këtë raport janë të autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet e KFOS-it.

PËRMBAJTJA

1	1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE
4	2. HYRJE
4	3. KORNIZA AKTUALE LIGJORE PËR DEKLARIMIN E PASURISË SË ZYRTARËVE TË LARTË PUBLIK
8	4. VAKUMI LIGJOR DHE SFIDAT E ZBATIMIT NË PRAKTIKË TË LIGJIT PËR DEKLARIMIN E PASURISË
11	5. ANALIZË NORMATIVE E PROJEKT-LIGJIT PËR DEKLARIMIN, PREJARDHJEN DHE KONTROLLIN E PASURISË
15	6.RESPEKTIMI I AFATAVE LIGJORE PËR DEKLARIMIN E PASURISË NGA MINISTRAT DHE ZËVËNDËSMINISTRAT E TRI QEVERIVE TË KALUARA
16	6.1 QEVERIA HARADINAJ
33	6.2 QEVERIA KURTI 1
39	6.3 QEVERIA HOTI
49	7. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Lëvizja FOL ka analizuar Ligjin për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, duke vënë në pah të metat e këtij ligji, si dhe ka analizuar formularët e deklarimit të pasurive të ministrave dhe zëvendësministrave të tri qeverive të kaluara (Qeverisë Haradinaj, Qeverisë Kurti 1 dhe Qeverisë Hoti) në lidhje me respektimin e afateve ligjore për deklarimin pasurisë me rastin e emërimit, deklarimin e rregullt vjetor dhe deklarimin me rastin e shkarkimit apo përfundimit të mandatit.

Analiza normative e ligjit na lejon të hedhim dritë mbi vakumin ligjor dhe paqartësitë që dalin nga kufizimet ligjore të përcaktuara në këtë ligj. Duke interpretuar secilin nen, shohim nevojën për ndërhyrje, e që do të rezultonte me një kornizë ligjore më efikase të deklarimit të pasurisë. Ndërkaq analizimi i formularëve të deklarimit të pasurive të ministrave dhe zëvendësministrave të tri qeverive të kaluara sa i përket respektimit të afateve për kategoritë e ndryshme të deklarimeve të pasurive ka për qëllim krijimin e një pasqyre të përgjithshme në lidhje me respektimin e ligjit nga ana e këtyre zyrtarëve.

Procesi manual i mbledhjes dhe plotësimit të regjistrave i cili aplikohet aktualisht, rrit mundësinë për gabime apo edhe lëshime nga zyrtarët kontaktues. Prandaj, shihet si shumë i nevojshëm digjitalizimi i tërë procesit të deklarimit të pasurisë.

Agjencia Kundër Korrupsion (në tekstin e mëtejshëm: agjencia) e ka mandatin dhe autoritetin për të kërkuar informacione, por autoriteti dhe kompetencat e saj janë të kufizuara. Pra agjencia nuk mund të hetoj origjinën e mundshme penale të pasurisë së pajustificuar. Po ashtu, ka mungesë të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve dhe mekanizmave relevant sa i përket hetimit të deklarimit të pasurisë.

Në listën e personave që nuk e kanë deklaruar pasurinë të publikuar nga agjencia, thuhet se 28 zyrtarë nuk e kanë deklaruar pasurinë me arsye (për shkaqe shëndetësore, pushime të lehonisë etj.).¹ mirëpo ligji në asnjë nen apo dispozitë nuk përcakton se në cilat raste, apo për çfarë arsye një zyrtar mund të mos e deklarojë pasurinë.

¹ Për më tepër shih: https://www.akk-ks.org/lajmi_i_plote/49337

Sipas dispozitave të ligjit që është në fuqi, agjencia nuk ka qasje në llogaritë bankare jashtë vendit të zyrtarëve publik, nuk ka të drejtë të kërkojë zbatimin e masave të vëzhgimit dhe hetimit, si dhe vihet në pah mos koordinimi me institucionet tjera relevante.

Ligji që aktualisht është në fuqi nuk parasheh obligime për agjencinë të bëjë analizimin e përputhjes në mes të të hyrave të zyrtarëve dhe pasurive të tyre. Kjo vërehet posaçërisht në çështjen e verifikimit të pasurisë, në rastet kur ekziston dallim i madh në pasuri brenda viteve, ku ligji nuk i kërkon agjencisë të vlerësojë mospërputhjet në mes të pasurisë, në rastet e akumulimit të shpejtë të saj.

Pavarësia e agjencisë është thelbësore për zbatimin e suksesshëm të sistemit të deklarimit. Mënyra aktuale e verifikimit të deklarimeve në Kosovë, ku 20% e zyrtarëve përzgjidhen përmes shortit, konsiderohet të jetë më pak efektive për shkak të rrezikut të lënies anash të një numri të zyrtarëve publik që potencialisht mund të jenë më të prirur ndaj korrupsionit.

Pra mangësitë kryesore që vërehen në ligjin aktual për deklarimin e pasurisë, janë kufizimi i kompetencave të agjencisë në procesin e kontrollimit të pasurisë së deklaruar nga zyrtarët publikë, mos rregullimi i hetimit të origjinës së pasurisë, mungesa e konfiskimit të pasurisë së paligjshme si masë ndëshkuese dhe përkufizimi i qartë i personave të obliguar të deklarojnë pasurinë.

Nga analizimi i formularëve të deklarimit të pasurisë së ministrave dhe zëvendësministrat e tri qeverive të kaluara, shihet se nga 131 zëvendësministrat/ministrat e Qeverisë Haradinaj, vetëm 62 nga ta kishin respektuar afatet ligjore për deklarim të pasurisë me rastin e emërimit në këtë pozitë (brenda një muaji nga emërimi në detyrë), si dhe deklarimin e rregullt vjetor, mirëpo asnjë nga ta nuk e ka deklaruar pasurinë me rastin e dorëzimit të detyrës zyrtare.

Nga 46 zëvendësministrat/ministrat e Qeverisë Kurti 1, vetëm 20 nga ta e kanë respektuar afatin ligjor për deklarim të pasurisë me rastin e emërimit në këtë pozitë. Ndërkaq asnjë nga ta, përveç një zyrtari, nuk e ka bërë deklarimin e pasurisë me rastin e dorëzimit të detyrës zyrtare apo me rastin e shkarkimit nga detyra.

Ndërkaq nga 77 zëvendësministrat/ministrat e Qeverisë Hoti, vetëm 32 prej tyre e kanë respektuar afatin ligjor për deklarim të pasurisë me rastin e emërimit në këtë pozitë, duke deklaruar pasurinë brenda periudhës së paraparë me ligj. Ndërkaq asnjë nga zyrtarët e kësaj qeverie nuk e ka deklaruar pasurinë me rastin e dorëzimit të detyrës zyrtare.

Ndërkaq çështjet kryesore të cilat FOL konsideron se duhet të përfshihen në Ligjin e ri për Deklarimin e Pasurisë janë:

- *Përkufizimi i qartë i personave që obligohen të deklarojnë pasurinë;*
- *Definimi i kompetencave të agjencisë në procesin e deklarimit të pasurisë dhe në hetimin e prejardhjes;*
- *Qasja e agjencisë në institucione financiare jashtë Kosovës në të cilat zyrtarët mund të kenë asete;*
- *Hartimi i një strategjie për ndërveprimin midis institucioneve kryesore në procesin e deklarimit të pasurisë, që të mundësohet koordinim i menjëhershëm në raste të korrupsionit apo keqpërdorimeve tjera;*
- *Të arrihet vlerësimi i asetëve të deklaruar në bazë të vlerës së tregut dhe të krahasohet me vlerat subjektive të paraqitura nga zyrtarët që deklarojnë pasurinë;*
- *Të ashpërsohen masat ndëshkimore ndaj personave që nuk e deklarojnë pasurinë;*
- *Kontrollit të plotë të deklarimit të pasurisë për çdo vit ti nënshtrohen të gjithë formularët e zyrtarëve të lartë publik;*
- *Të qartësohet se a kërkohet të bëhet deklarimi i pasurisë për pagesa në baza mujore apo vjetore;*
- *Të shpjegohen më mirë procedurat e llojeve të deklarimit të pasurisë;*
- *Të definohet statusi pronësor i secilës pronë veç e veç, në kuptimin e bërjes së dallimit se a është pasuri e përbashkët e bashkëshortëve apo pasuri e veçantë. Të definohet qartë pasuria e përbashkët e bashkëshortëve edhe në formularë, etj.*

2. HYRJE

Deklarimi i pasurisë nga ana e zyrtarëve publik qenësisht kontribuon në rritjen e transparencës dhe forcimin e besimit të qytetarëve ndaj institucioneve publike, si parakusht në parandalimin e konfliktit të interesit në institucione publike dhe në monitorimin e ndryshimeve eventuale të pasurisë së politikanëve në mënyrë që të parandalohet keqpërdorimi, apo edhe deklaratimet e rrejshme.

Për të shërbyer si instrument për luftimin dhe parandalimin e korrupsionit dhe për të qenë sa më efektiv, sistemi i deklarimit të aseteve duhet të jetë i organizuar mirë, duke u nisur nga korniza ligjore që e rregullon këtë proces e deri tek mekanizmat që merren me deklarimin e aseteve të zyrtarëve publik.

Sipas Raportit të Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2020, ekziston një nevojë për një vullnet të fortë politik për të adresuar në mënyrë efektive çështjet e korrupsionit, si dhe një përgjegjësi e fortë e drejtësisë penale ndaj korrupsionit të nivelit të lartë. Sipas raportit, Kosova ka bërë progres të kufizuar në këtë fushë, përfshirë hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të nivelit të lartë, në konfiskimin e pasurive si dhe përmes krijimit të departamenteve speciale që trajtojnë rastet në lidhje me korrupsionin e nivelit të lartë (dhe krimin e organizuar) në gjykata.

Raporti i Komisionit Evropian gjithashtu thekson se sistemi për deklarimin dhe vlerësimin e prejardhjes së pasurisë që i përket zyrtarëve të lartë publikë mbetet i paplotë. Agjencisë ende i mungojnë mjetet dhe burimet për të verifikuar deklaratat e pasurisë.

Korniza ligjore për deklarimin e pasurisë në Kosovë, përgjatë viteve ka kaluar nëpër disa ndryshime. Në vitin 2010, Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin Nr.03/L-151 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publikë. Në vitin 2011, ky ligj shfuqizohet pas miratimit të Ligjit Nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të Gjithë Personat Zyrtarë. Ndërkaq në vitin 2014 hyn në fuqi Ligji Nr. 04/L-228 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-050.

Kodi Penal i Republikës së Kosovës, i miratuar në vitin 2013, parasheh si vepër penale mos deklarimin e pasurisë, deklarimin e rremë në agjenci dhe konfliktin e interesit². Për më tepër, paragrafi 3 i nenit 437 thekson se “vlera e padeklaruar e pasurisë, të të ardhurave ose të dobisë tjetër pasurore, e cila është fituar në mënyrë joligjore konfiskohet”³, mirëpo kjo nuk është e përfshirë në ligjin aktual për deklarimin e pasurisë, duke mos e përfshirë konfiskimin fare si masë ndëshkimore.

Agjencia Kundër Korrupsion në anën tjetër, e themeluar me Ligjin Nr.03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsion, është përgjegjëse ndër të tjera për të monitoruar zbatimin e dy instrumenteve kryesore legjislative – Ligjin për Konfliktin e Interesit dhe Ligjin për Deklarimin e Pasurisë

2. KORNIZA AKTUALE LIGJORE PËR DEKLARIMIN E PASURISË SË ZYRTARËVE TË LARTË PUBLIK

Ndër veprat penale të korrupsionit, të parapara në Kapitullin e XXXVIII të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, përfshihet edhe mos deklarimi apo deklarimi i rremë i pasurisë së personave që në bazë të ligjit janë të obliguar ta deklarojnë atë.

Sipas paragrafit 1 të nenit 430 të Kodit Penal, çdo person, i cili sipas ligjit është i detyruar të bëjë deklarimin e pasurisë, të të ardhurave, të dhuratave, të dobisë tjetër pasurore ose të detyrimeve financiare, dhe i cili nuk e bën një gjë të tillë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.⁴

Ndërkaq sipas paragrafit 2 të këtij neni, çdo personi cili bën deklaratë të rreme ose nuk paraqet të dhënat e kërkuara në deklaratë, dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.⁵

⁴ Kodi nr. 06/I-074 Penal i Republikës së Kosovës

⁵ Po aty

Ligji nr.04/L-050 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë⁶, si dhe plotësim/ndryshimet e këtij ligji të bëra në vitin 2014, përcaktojnë detyrimet e zyrtarëve të lartë publik për të deklaruar pasurinë dhe rregullojnë hollësisht procedurën e deklarimit dhe kontrollin e pasurisë së këtyre zyrtarëve, si dhe dispozitat ndëshkimore në rast të shkeljes së detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj.

Për dallim nga përkufizimi i anëtarit të familjes në Kodin Penal⁷ dhe në Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit⁸, Ligji aktual për Deklarimin e Pasurisë përkufizon si anëtar të familjes “...prindërit, adoptuesi, bashkëshortët, fëmijët dhe i adoptuari deri në moshën 18 vjeçare”⁹, duke e kufizuar rrethin familjar e rrjedhimisht duke e kufizuar edhe numrin e personave ndaj të cilëve mund të merren masa hetimore në rast të keqpërdorimeve, e më tutje duke e rritur mundësinë që zyrtarët të fshehin pasurinë e tyre tek familjarët ndaj të cilëve nuk vlejnë masat hetuese.

Sipas këtij ligji, deklarimi i pasurisë nga zyrtarët e lartë publik mund të jetë:

- **Deklarimi i rregullt vjetor i pasurisë**, i cili bëhet gjatë kohës së ushtrimit të funksionit publik, nga data 1 mars deri me 31 mars, për vitin paraparak nga 1 janar deri me 31 dhjetor.
- **Deklarimi me rastin e marrjes së detyrës**. Pra zyrtari i lartë publik obligohet të deklaroj pasurinë ekzistuese, burimin dhe detyrimet brenda afatit tridhjetë (30) ditorë nga marrja e funksionit.
- **Deklarimi sipas kërkesës së Agjencisë**. Pra Agjencia në çdo kohë mund të kërkojë nga zyrtari i lartë publik që ta dorëzojë informacionin e kërkuar, si dhe
- **Deklarimi pas mbarimit apo shkarkimit nga funksioni publik**, në të cilën zyrtari i lartë publik obligohet që brenda tridhjetë (30) ditëve paraqet deklarimin e pasurisë.

⁶ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji nr.04/L-050 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë.

⁷ Kodi Penal i Kosovës, Neni 120, Përkufizimet: 3) Anëtar i familjes - prindi, prindi i adoptuar, fëmija, fëmija i adoptuar, vëllai ose motra, bashkëshorti ose bashkëshortja, i afërmi i gjakut që jeton në të njëjtën shtëpi ose personi me të cilin kryesi jeton në bashkësi jashtëmartesore.

⁸ Ligji Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit Të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, Neni 3 Përkufizimet: **Person i afërt me zyrtarin** – bashkëshorti ose personi që bashkëjeton, të afërmit në vijë të drejtë të gjakut pa kufizime, të afërmit në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt, adoptuesi, i adoptuari, në gjini të krushqisë deri në shkallën e dytë.

⁹ Ligji Nr. 04/L-228 Për Ndryshimin Dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-050 Për Deklarimin, Prejardhjen Dhe Kontrollin E Pasurisë së Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të Gjithë Personat Zyrtarë, neni 1.

Sipas nenit 14 të këtij ligji, agjencia paraqet kallëzim penal në prokurorinë kompetente ndaj zyrtarëve të lartë publik që shkelin detyrimet e parapara me këtë ligj, e që përbëjnë vepër penale sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës

Gjithashtu sipas ligjit, agjencia kërkon deklarin e pasurive dhe burimet e krijimit të tyre si dhe mund të bëjë kontrollin dhe saktësinë e këtyre deklarimeve. Për verifikimin e vërtetësisë së këtyre të dhënave, agjencia mund të kërkoj apo shfrytëzoj të dhënat nga të gjithë personat fizik apo juridik, në pajtim me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Kur gjatë kontrollit të plotë zbulohet se deklarimi nuk është i saktë ose burimi i deklaruar nuk identifikohet dhe nuk mbulon pasuritë e deklaruara, Agjencia kërkon nga zyrtari për të dhënë shpjegime dhe argumente përkatëse të cilat paraqiten me shkrim brenda 15 ditëve.

Sipas nenit 17 të këtij ligji, kontrollit të plotë çdo vit i nënshtrohen të paktën 20% e formularëve. Përzgjedhja e deklaratave që i nënshtrohen kontrollit të plotë bëhet me short. Procedura e shortit është e hapur për publikun. Lista e zyrtarëve ndaj të cilëve ushtrohet kontrolli i plotë është publike. Agjencia publikon 30 ditë përpara datës së hedhjes së shortit dhe 15 ditë pas hedhjes së shortit listën e zyrtarëve që i nënshtrohen kontrollit të plotë. Ndërkaq publikimi bëhet në ueb-faqen zyrtare të agjencisë dhe të paktën në një gazetë ditore.¹⁰

Pra Agjencia kundër Korrupsion është institucioni qendror për zbatimin e dispozitave të këtij ligji. Ndërkaq statusin dhe përgjegjësitë e agjencisë në fushën e luftimit dhe parandalimit të korrupsionit, veçanërisht në fushën e raportimit, zbulimit dhe hetimit të korrupsionit, si dhe zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër Korrupsionit i rregullon Ligji nr. 03/L-050 për Agjencinë kundër Korrupsionit.¹¹

Në nenin 5 të këtij ligji janë përcaktuar kompetencat e këtij institucioni, ku ndër të tjera theksohet obligimi për:

- *Mbikëqyrjen e pasurisë së zyrtarëve të lartë publik dhe të personave të tjerë,*
- *Mbikëqyrjen e pranimit të dhuratave që kanë të bëjnë me kryerjen e detyrës zyrtare dhe ndërmarrjen e masave të parapara me ligj,*
- *Ofrimin e opinioneve në lidhje me konfliktin e interesit dhe mbikëqyrjen e dhuratave që kanë të bëjnë me kryerjen e detyrës zyrtare,*
- *Ofrimin e sqarimeve në lidhje me mënyrën e deklarimit të pasurisë dhe çështjeve të tjera nga fushë veprimtaria e Agjencisë etj.*

¹⁰ Ligji nr. 04/L-228 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-050 për deklarin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, neni 9, paragrafi 3.

¹¹ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji nr. 03/L-050 për Agjencinë kundër Korrupsionit, neni 5.

4. VAKUMI LIGJOR DHE SFIDAT E ZBATIMIT NË PRAKTIKË TË LIGJIT PËR DEKLARIMIN E PASURISË

Sipas nenit 4 të Ligjit aktual për Deklarimin e Pasurisë, secili institucion cakton një zyrtar kontaktues i cili duhet të jetë nga Zyra e Personelit që përcjell listën me emrat e zyrtarëve të lartë, njofton zyrtarët e lartë për deklarim si dhe regjistron dhuratat e pranuar nga personat zyrtar në regjistrin e institucionit, po ashtu dorëzon kopjen e regjistrit tek AKK deri me 31 mars të secilit vit kalendarik.

Mirëpo ky proces manual i mbledhjes dhe plotësimit të regjistrave rrit mundësinë për gabime apo edhe lëshime nga zyrtarët kontaktues. Prandaj, shihet si shumë i nevojshëm digjitalizimi i tërë procesit të deklarimit të pasurisë. Kjo, përveç që do të zvogëlonte mundësinë e gabimit, do të shërbente edhe si mjet më i lehtë që mekanizmat e përfshirë në këtë proces, të mund të bashkëpunojnë në rast të keqpërdorimeve apo rasteve të korrupsionit.

Në nenin 5 të ligjit që është në fuqi, implikohen anëtarët e familjes së zyrtarit publik në procesin e deklarimit të pasurisë. Sipas këtij neni *“kur pasuria e pjesëtarëve të familjes është e ndarë dhe e regjistruar si e tillë në organet e administratës shtetërore ose gjyqësore, deklarimi paraqitet veçmas për çdo anëtarë të familjes me pasuri të regjistruar në emër të tij dhe i bashkëngjitet deklaratës së personit që ka detyrimin për deklarimin”*. Mirëpo formularët e AKK-së për deklarim të pasurisë, përfshijnë në një vend/formular edhe asetet që janë të regjistruar në emër të ndonjë anëtarit tjetër të familjes së zyrtarit publik, duke e vështirësuar hetimin e këtyre aseteve ndër vite.

Më tutje në po këtë nen, në paragrafin 3, thuhet: *“në deklaratën për pasurinë e të ardhurave dhe detyrimeve financiare, zyrtari i lartë publik cek shumën, llojin dhe burimin e secilës të ardhur, shumën dhe llojin e detyrimeve financiare duke përfshirë edhe emrin e kreditorit si person fizik apo juridik, ndërsa publikimi i emrit të kreditorit bëhet vetëm për personat juridik”*. Problemi qëndron në faktin se vlerësimin e pasurisë e bën vet zyrtari, duke lënë mundësi për vlerësim subjektiv, përkatësisht vlera e atij asetit mund të mos jetë e vërtetë.

Sipas deklaratës së AKK-së të bërë me 27 prill 2021, thuhet se nga 4892 zyrtarë të lartë publik, 4783 zyrtarë kanë bërë deklarimin e pasurisë në përputhje me Ligjin për Deklarimin e Pasurisë. Ndërkaq në listën e personave që nuk e kanë deklaruar pasurinë të publikuar nga AKK, thuhet

se 28 zyrtarë nuk e kanë deklaruar pasurinë me arsye (për shkaqe shëndetësore, pushime të lehonisë etj.)¹², mirëpo ligji në asnjë nen apo dispozitë nuk përcakton se në cilat raste, apo për çfarë arsye një zyrtar mund të mos e deklarojë pasurinë. Pra në ligjin që aktualisht është fuqi, mos deklarimi i pasurisë nuk njihet arsyetim.

Siç u përmend edhe më lartë, ligji aktual i jep kompetenca të kufizuara AKK-së. Në nenin 9 të ligjit thuhet se AKK-ja në çdo kohë mund të kërkojë nga zyrtari i lartë publik që të dorëzojë informacionet e kërkuara.

Gjithashtu, sipas këtij neni, me kërkesë të agjencisë, bankat dhe subjektet e tjera, që ushtrojnë veprimtari bankare dhe financiare në Kosovë, detyrohen të japin të dhëna për depozitat, llogaritë dhe transaksionet e kryera nga personat që sipas këtij ligji, kanë detyrimin për deklarim. Kjo nënkupton se agjencia nuk ka qasje në llogaritë bankare jashtë vendit të zyrtarëve publik, nuk ka të drejtë të kërkojë zbatimin e masave të vëzhgimit dhe hetimit, si dhe vihet në pah mos koordinimi me institucionet tjera relevante, siç janë agjencitë kadastrale për hetimin ndaj paluajtshmërive të deklaruara nga zyrtarët publik.

Ndonëse paragrafi 2 i nenit 16 thotë se *“gjatë kryerjes së kontrollit dhe verifikimit të të dhënave të deklarimit të pasurisë, Agjencia mund të kërkojë apo shfrytëzojë të dhënat nga të gjithë personat fizik dhe juridik, konform Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”*, nuk ekziston një sistem i bashkë-koordinimit mes agjencisë dhe institucioneve tjera që luftojnë korrupsionin, që do të bënte më të shpejtë detektimin e rasteve të deklarimit të rrejshëm apo ndonjë keqpërdorimi tjetër që mund të vij gjatë deklarimit të aseteve nga zyrtarët publik.

Pavarësia e agjencisë është thelbësore për zbatimin e suksesshëm të sistemit të deklarimit. Mënyra aktuale e verifikimit të deklarimeve në Kosovë, ku 20% e zyrtarëve përzgjidhen përmes shortit, konsiderohet të jetë më pak efektive për shkak të rrezikut të lënies anash të një numri të zyrtarëve publik që potencialisht mund të jenë më të prirur ndaj korrupsionit.

Problemi tjetër shfaqet se ligji nuk i jep kompetencë agjencisë që të bëjë analizimin e përputhjes në mes të hyrave të zyrtarëve dhe pasurive të tij. Kjo mangësi ligjore vërehet posaçërisht në çështjen e verifikimit të pasurisë, në raste kur ekziston dallim i madh në pasuri brenda viteve, ku ligji nuk i kërkon agjencisë të vlerësojë mospërputhjet në mes të pasurisë, në rastet e akumulimit të shpejtë të saj.

¹² Për më tepër, shih: https://www.akk-ks.org/lajmi_i_plote/49337

Gjithashtu, sipas këtij neni, me kërkesë të agjencisë, bankat dhe subjektet e tjera, që ushtrojnë veprimtari bankare dhe financiare në Kosovë, detyrohen të japin të dhëna për depozitat, llogaritë dhe transaksionet e kryera nga personat që sipas këtij ligji, kanë detyrimin për deklarim. Kjo nënkupton se agjencia nuk ka qasje në llogaritë bankare jashtë vendit të zyrtarëve publik, nuk ka të drejtë të kërkojë zbatimin e masave të vëzhgimit dhe hetimit, si dhe vihet në pah mos koordinimi me institucionet tjera relevante, siç janë agjencitë kadastrale për hetimin ndaj paluajtshmërive të deklaruara nga zyrtarët publik.

Ndonëse paragrafi 2 i nenit 16 thotë se “gjatë kryerjes së kontrollit dhe verifikimit të të dhënave të deklarimit të pasurisë, Agjencia mund të kërkojë apo shfrytëzojë të dhënat nga të gjithë personat fizik dhe juridik, konform Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, nuk ekziston një sistem i bashkë-koordinimit mes agjencisë dhe institucioneve tjera që luftojnë korrupsionin, që do të bënte më të shpejtë detektimin e rasteve të deklarimit të rrejshëm apo ndonjë keqpërdorimi tjetër që mund të vij gjatë deklarimit të aseteve nga zyrtarët publik.

Pavarësia e agjencisë është thelbësore për zbatimin e suksesshëm të sistemit të deklarimit. Mënyra aktuale e verifikimit të deklarimeve në Kosovë, ku 20% e zyrtarëve përzgjidhen përmes shortit, konsiderohet të jetë më pak efektive për shkak të rrezikut të lënies anash të një numri të zyrtarëve publik që potencialisht mund të jenë më të prirur ndaj korrupsionit.

Problemi tjetër shfaqet se ligji nuk i jep kompetencë agjencisë që të bëjë analizimin e përputhjes në mes të hyrave të zyrtarëve dhe pasurive të tij. Kjo mangësi ligjore vërehet posaçërisht në çështjen e verifikimit të pasurisë, në raste kur ekziston dallim i madh në pasuri brenda viteve, ku ligji nuk i kërkon agjencisë të vlerësoj mospërputhjet në mes të pasurisë, në rastet e akumulimit të shpejtë të saj.

5. ANALIZË NORMATIVE E PROJEKT-LIGJIT PËR DEKLARIMIN, PREJARDHJEN DHE KONTROLLIN E PASURISË

Qeveria e Republikës së Kosovës me vendimin nr.20/21 të datës 20.12.2017 kishte aprovuar Koncept Dokumentin për Fushën e Agjencisë Kundër Korrupsionit, si dhe për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë.

Në versionin punues të Projektligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e pasurisë parashihen të merren një varg ndryshimesh në rregullimin e çështjes së deklarimit të pasurisë së zyrtarëve publik.

Si një ndër ndryshimet substanciale që parashihet të bëhet në ligjin e ri është zgjerimi i gamës së personave që obligohen të deklarojnë pasurinë.

Përveç zyrtarëve të lartë publik, deklarimi i pasurisë parashihet të bëhet obligim edhe për zyrtarë të tjerë publik, si: *ekspertët mjeko-ligjor, profesorët e Universiteteve Publike, udhëheqësit e njësive të auditimit, auditorët e brendshëm si dhe auditorët në zyrën kombëtare të auditimit, inspektorët policor, inspektorët e nivelit qendror dhe lokal dhe të gjithë zyrtarët e tjerë që ushtrojnë autorizime inspektimi, personat përgjegjës dhe ndërmarrjet publike të nivelit lokal dhe qendror; zyrtarët doganor, inspektorët tatimor si dhe hetuesit policor dhe gjithë zyrtarët tjerë që kryejnë detyra hetimi, inspektimi, verifikimi apo certifikimi.*¹³

Në lidhje me këtë, Fol konsideron se përfshirja e mjekëve, profesorëve dhe asistentëve universitar në listën e personave që obligohen të deklarojnë pasurinë do të ndikonte në vështirësimin e zbatimit të ligjit në praktikë, për shkak të mungesës së kapaciteteve dhe burimeve njerëzore të AKK-së, si dhe do të ndikonte në dekurajimin e këtyre kategorive në kryerjen e funksioneve, prandaj përfshirja e tyre në ligjin e ri duhet të përjashtohet.¹⁴

¹³ Projekt-ligji për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë, neni 5.

¹⁴ Disa nga këto rekomandime kanë dalur nga punëtoria e mbajtur në Durrës me 12-14 qershor në lidhje me deklarimin e pasurisë.

Sipas projekt-ligjit, në deklarimin e pasurisë, subjekti deklarues do të përfshijë të dhënat mbi origjinën e pasurisë dhe të hyrave të përdorura për blerjen e pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme, të cilat subjekti deklarues është i obliguar t'i deklarojë sipas ligjit. Të dhënat mbi pasurinë e trashëguar do të përfshijnë të dhënat mbi llojin dhe vlerën e trashëgimisë, përfshirë edhe të dhënat se nga kush e kanë trashëguar.

Pra për të gjitha të dhënat e paraqitura në formularin e deklarimit të pasurisë, subjektet deklaruese obligohen të ofrojnë dëshmitë përkatëse për prejardhjen e pasurisë sipas kërkesës së agjencisë.

Kjo do të thotë se në ligjin e ri, roli i agjencisë pritet të rritet në aspekt të hetimit të prejardhjes apo burimit të pasurisë së deklaruar nga zyrtarët publik, nëse krahasohet me autorizimet që kësaj agjencie ia jep ligji që aktualisht është në fuqi. Mirëpo krahas kësaj, shihet nuk e ka nevojë të mëtutjeshme për konkretizimin e mandatit dhe detyrave të agjencisë, si dhe specifikimin e ndërveprimit me institucione të tjera relevante.

Projekt-ligji parasheh se të paktën një e treta (1/3) e subjekteve deklaruese i nënshtrohen rregullisht kontrollit të plotë çdo vit nga lista e zyrtarëve të lartë. FOL konsideron se numri i zyrtarëve të cilët duhet të ju nënshtrohen rregullisht kontrollit të deklarimit të pasurisë duhet të rritet në mënyrë që të minimizohet rreziku i lënies anash të një numri të zyrtarëve publik që potencialisht mund të jenë më të prirur ndaj korrupsionit.

Ndryshim tjetër që është konsultuar të përfshihet në ligjin e ri të deklarimit të pasurisë, është shtimi i deklarimit ad hoc në kuadër të llojeve të deklarimeve të pasurisë nga subjektet deklaruese, që do të prekë vetëm zyrtarët e lartë publik. Pra sipas këtij lloji të deklarimit, zyrtarët e lartë dorëzojnë një deklaram ad hoc sa herë që ka një rritje prej më shumë se 20% të situatës së pasurive të raportuara ose ndonjë ndryshim tjetër që ndodh në lidhje me statusin juridik në lidhje me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme.¹⁵

Gjithashtu, risi tjetër substanciale që përfshihet të inkorporohet në ligjin e ri, është krijimi e mënyrës elektronike të deklarimit të pasurisë. Pra subjektet deklaruese obligohen të deklarojnë në mënyrë elektronike deklaratën e pasurisë, duke përdorur sistemin e agjencisë për deklarimin elektronik të pasurisë. Agjencia i mundëson çdo zyrtari deklarues qasje të sigurt individuale në sistemin e saj elektronik për deklarimin e pasurisë.

¹⁵ Projekt-ligji për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë, neni 11.

Projekt-ligji parasheh se vetëm deklarimi i pasurisë së zyrtarëve të lartë është publik, ndërsa deklarimi i pasurisë së zyrtarëve të tjerë nuk është publik.

Në nenin 15 të projekt-ligjit thuhet se subjektet deklaruese obligohen të deklarojnë pasurinë e anëtarëve të familjes me të cilët jetojnë në bashkësi familjare. Anëtarët e familjes për të cilët subjekti deklarues deklaron pasurinë janë si në vijim: bashkëshortët, bashkëshortët jashtëmartesorë, prindërit, dhe fëmijët.

Pra shihet se në ligjin e ri synohet të ngushtohet rrethi i familjarëve të personave zyrtarë që duhet të deklarojnë pasurinë në raport me ligjin që aktualisht është në fuqi, e ende më shumë në raport me përkufizimin që Kodi Penal i Kosovës parasheh për anëtarët e familjes¹⁶. Në këtë mënyrë kufizohet numri i personave ndaj të cilëve mund të merren masat hetimore në rast të keqpërdorimeve, e në anën tjetër rritet mundësia që zyrtarët të fshehin pasurinë e tyre tek familjarët ndaj të cilëve nuk vlejnë masat hetuese. Pra FOL konsideron se duhet të merrem parasysh dispozitat e Kodit Penal të Republikës së Kosovës në lidhje me përkufizimin që i jep anëtarëve të familjes.

FOL gjithashtu konsideron se duhet të ndalohet pranimi i dhuratave të rastit nga zyrtarët publik. Kjo për shkak se pranimi i dhuratave të rastit nga personat zyrtarë, të cilët kanë detyrim ligjor ti kryejnë detyrat dhe funksionet e tyre, është i paarsyeshëm dhe i panevojshëm.¹⁷

Projekt-ligji gjithashtu synon të sjell masa të tjera ndëshkimore për kundërvajtje ndaj personave që nuk e deklarojnë pasurinë brenda kohës së paraparë në këtë ligj. Sipas nenit 23 të këtij ligji, agjencia shqipton gjobë dhe qortim publik ndaj secilit subjekt deklarues i cili nuk përmbush kërkesat brenda afatit të paraparë, me vërejtje se nëse vazhdon me kryerjen e cilësdo shkelje të paraparë me paragrafin 1 të këtij neni pas afatit shtesë prej 8 ditëve, ndaj të njëjti do të ushtrohet kallëzim penal.

Gjoka e shqiptuar do të vendoset në shumën deri në 30% të pagës mujore neto të subjektit deklarues, por në asnjë rast kjo shumë nuk do të kalojë pragun prej 500 euro.¹⁸

¹⁶ Kodi Penal i Kosovës, neni 120, Përkufizimet: 3) Anëtar i familjes - prindi, prindi i adoptuar, fëmija, fëmija i adoptuar, vëllai ose motra, bashkëshorti ose bashkëshortja, i afërmi i gjakut që jeton në të njëjtën shtëpi ose personi me të cilin kryesi jeton në bashkësi jashtëmartesore

¹⁷ Kjo çështje është diskutuar në punëtorinë e mbajtur në Durrës të organizuar nga Lëvizja FOL me akter të institucioneve publike dhe organizata të shoqërisë civile lidhur me Ligjin për Deklarimin të Pasurisë.

¹⁸ Projekt-ligji për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë, neni 23, par. 3.

Kjo nënkupton së në këtë projekt-ligj parashihet lehtësimi i masave ndëshkimore për kundërvajtje, krahasuar me ligjin në fuqi, i cili parasheh dënime me gjobë prej 1000 deri në 2500 euro ndaj zyrtarit të lartë publik për mos deklarim të rregullt vjetor të pasurisë, si dhe gjoba të ngjashme për mos deklarimet tjera.

Rrjedhimisht, FOL konsideron se ashpërsimi i masave ndëshkimore ndaj personave që nuk veprojnë në përputhje me dispozitat e këtij ligji duhet të shihet si nevojë imanente për zbatimin dhe implementimin e duhur të ligjit, si dhe për ngritjen e vigjilencës së zyrtarëve publik që t'a kryejnë këtë detyrim ligjor.

Risi tjetër që parashihet të përfshihet në ligjin e ri, është se subjekti deklarues i cili për arsye të caktuara nuk ka qenë në gjendje të deklarojë pasurinë brenda afatit të caktuar ose nuk mund të përmbush ndonjë

kërkesë tjetër të Agjencisë, duhet të paraqesë prova që vërtetojnë rrethanat objektive që kanë shpie në mosdeklarim të pasurisë ose mos përmbushje të kërkesave tjera të agjencisë.¹⁹

Kjo çështje në ligjin që aplikohet aktualisht nuk është përmendur në asnjë dispozitë të saj dhe FOL konsideron se përfshirja e saj në ligjin e ri duhet të bëhet vetëm me specifikimin e rrethanave dhe kushteve që do të përbënin arsye të fortë për mos deklarim të pasurisë, në mënyrë që të minimizohet mundësia e keqpërdorimit të kësaj mundësie të dhënë nga ligji nga personat që obligohen të deklarojnë pasurinë.

¹⁹ Po aty, par. 6.

6. RESPEKTIMI I AFATAVE LIGJORE PËR DEKLARIMIN E PASURISË NGA MINISTRAT DHE ZËVENDËSMINISTRAT E TRI QEVERIVE TË KALUARA

Ligji për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik që aktualisht është në fuqi përcakton katër kategori të deklarimit të pasurisë: deklarimin e rregullt vjetor, deklarimi me marrjen e detyrës së zyrtarit të lartë publik, deklarimin sipas kërkesës së Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe deklarimin pas largimit apo shkarkimit nga funksioni.

Lëvizja FOL ka analizuar deklarinimet në formularët e deklarimit të pasurive të ministrave dhe zëvendësministrave të tri qeverive të fundit: Qeverisë Haradinaj, Qeverisë Kurti 1 dhe Qeverisë Hoti. Pra ky kapitull përmban të dhëna në lidhje me nivelin e respektimit të afateve ligjore për deklarim të pasurisë së këtyre zyrtarëve me rastin e emërimit, deklarimit të rregullt vjetor, shkarkimit apo përfundimit të detyrës zyrtare.

Nga 131 zëvendësministrat/ministrat e Qeverisë Haradinaj të emëruar gjatë këtij mandati, vetëm 62 nga ta kishin respektuar afatet ligjore për deklarim të pasurisë me rastin e emërimit në këtë pozitë (brenda një muaji nga emërimi në detyrë), si dhe deklarimin e rregullt vjetor, mirëpo asnjë nga ta nuk ka deklaruar pasurinë me rastin e dorëzimit të detyrës zyrtare.

Nga 45 zëvendësministrat/ministrat e Qeverisë Kurti 1, vetëm 20 nga ta e kanë respektuar afatin ligjor për deklarim të pasurisë me rastin e emërimit në këtë pozitë. Ndërkaq, vetëm 15 nga ta e kanë bërë deklarimin e pasurisë me rastin e dorëzimit të detyrës zyrtare apo me rastin e shkarkimit nga detyra.

Nga 77 zëvendësministrat/ministrat e Qeverisë Hoti, vetëm 32 prej tyre e kanë respektuar afatin ligjor për deklarim të pasurisë me rastin e emërimit në këtë pozitë, duke deklaruar pasurinë brenda periudhës së paraparë me ligj. Ndërkaq asnjë nga zyrtarët e kësaj qeverie nuk ka deklaruar pasurinë me rastin e dorëzimit të detyrës zyrtare.

Në vijim të këtij raporti janë paraqitur të dhëna specifike për secilin prej ministrave dhe zëvendësministrave të Qeverisë Haradinaj, Qeverisë Kurti 1 dhe Qeverisë Hoti në lidhje me respektimin e afateve ligjore për deklarimin e pasurisë me rastin e marrjes së detyrës zyrtare, deklarimin e rregullt vjetor dhe deklarimin me rastin e përfundimit të mandatit apo shkarkimit.²¹

²¹ Këto të dhëna janë marrur në ueb-faqen zyrtare të Agjencisë Kundër Korrupsionit (AKK).

Duhet të theksohet se FOL në këtë raport nuk ka përfshirë të dhënat për deklarin e rregullt vjetor të pasurisë së zyrtarëve për vitin 2020, pra të Qeverisë Kurti 1 dhe Hoti, për shkak se ky deklarin përfshinë afatin e rregullt vjetor. Ky deklarin do të paraqitet në përditësimin e platformës së deklarin, të cilën FOL e bënë çdo vit.

6.1 QEVERIA HARADINAJ

Ramush Haradinaj është votuar në Kuvend si “Kryeministër i Republikës së Kosovës” me 10.09.2017 dhe i njëjti nuk e ka bërë deklarin me rastin e emërimit në këtë pozitë, por vetëm deklarin e rregullt vjetor.

Enver Hoxhaj është votuar në Kuvend në pozitën “Zëvendëskryeministër” me 10.09.2017, dhe i njëjti nuk ka bërë deklarin me rastin e emërimit në këtë pozitë. Ai ka bërë vetëm deklarin e rregullt vjetor.

Albena Reshitaj është emëruar “Ministre në Ministrinë e Mjedisit” me 10.09.2020. Ajo ka respektuar afatin ligjor për deklarin të pasurisë me rastin e emërimit në këtë pozitë, duke deklaruar pasurinë brenda periudhës së paraparë me ligj (me 11.10.2017). Ajo ka bërë edhe deklarin e rregullt vjetor.

Behxhet Pacolli është votuar në Kuvend në pozitën “Zëvendëskryeministër i Parë” dhe “Ministër i Punëve të Jashtme” me 10.09.2017. Pacolli nuk e ka bërë deklarin e pasurisë me rastin e emërimit në këtë pozitë, por vetëm deklarin e rregullt vjetor.

Fatmir Limaj është votuar në Kuvend si “Zëvendëskryeministër” me 10.09.2017, ai ka deklaruar pasurinë me rastin e marrjes së detyrës zyrtare duke respektuar afatin ligjor me (10.10.2017). Ai nuk ka bërë deklarin me rastin e dorëzimit të mandatit, por vetëm deklarin e rregullt vjetor të pasurisë.

Dardan Gashi është votuar në Kuvend si “Zëvendëskryeministër” me 10.09.2017, dhe i njëjti e ka deklaruar pasurinë vetëm me rastin e marrjes së detyrës zyrtare duke respektuar afatin ligjor.

Dalibor Jevtic është votuar në Kuvend në pozitën “Zëvendëskryeministër” si dhe “Ministër i Ministrisë për Komunitete dhe Kthim” me 10.09.2017. I njëjti nuk ka bërë deklarin me rastin e emërimit në këtë pozitë, por vetëm deklarin e rregullt vjetor.

